



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 korrik 2024
Nr. ref.: RK 2464/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI158/22

Parashtrues

Ahmet Meha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ARJ. UZVP. nr. 15/2022], të 24 shkurtit 2022, të Gjykatës Supreme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ahmet Meha (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), nga Komuna e Drenasit, i përfaqësuar nga Ramiz Suka, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [ARJ. UZVP. nr. 15/2022] e 24 shkurtit 2022, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [AA. nr. 886/2021] e 3 dhjetorit 2021, të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktvendimin [C. nr. 494/19/] e 25 gushtit 2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 21 qershor 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 20 [Vendimet] dhe 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 13 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën përmes postës, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) e pranoi më 17 tetor 2022.
8. Më 26 tetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. Gjr. KI158/22] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzije-Istrefi Peci (anëtarë).
9. Më 25 tetor 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
10. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të njoftojë Gjykatën lidhur me datën se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktin e kontestuar.

11. Më 26 tetor 2022, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
12. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 17 janar 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe vendosi që rasti të shtyhet për shqyrtim në një nga seancat e radhës, me kërkesë që i njëjti të plotësohet.
14. Më 30 janar 2024, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore dosjen e plotë të lëndës.
15. Më 2 shkurt 2024, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dosjen e kërkuar.
16. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
17. Më 30 prill 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ka qenë në marrëdhënie pune në pozitën postier tek Posta dhe Telekom i Kosovës nga 2 gushti 1999 deri më datën e pensionimit 21 mars 2008.
19. Më 8 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë për njohjen e të drejtës në pension kontribut-pagues në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Parashtruesi i kërkesës përmes kërkesës së tij pretendonte se shumica e pensionit të tij do të duhej të ishte 140 euro.
20. Më 13 prill 2016, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nxori vendimin përmes të cilit vendosi të miratoj ankesën e parashtruesit të kërkesës për njohjen e të drejtës në pension kontribut-pagues të moshës në shumën prej 158 euro, duke filluar prej 1 shkurtit 2016, në pajtim me nenin 8 të Ligjit 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti me arsyetimin se parashtruesi ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme në kuptim të ligjit të cekur më lart, për 15 vite stazh kontributiv.
21. Nga pohimet në shkresat e lëndës të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës rezulton se nga 21 marsi 2008 e deri më 5 maj 2016, parashtruesi kishte marr pensionin e pleqërisë vetëm 75 euro, ndërsa pas 5 majit 2016 ai e merr pensionin e plotë në shumë prej 140 euro.
22. Më 25 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore kundër të paditurës Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke pretenduar se nga 21 marsi 2008 e deri më 5 maj 2016, parashtruesi kishte marr pensionin e pleqërisë vetëm 75 euro, ndërsa pas 5 majit 2016 ai e merr pensionin e plotë në shumë prej 140 euro. Lidhur me këtë çështje, parashtruesi përmes padisë së tij kërkoi nga Gjykata Themelore "*dallimin në të holla për tetë (8), për shumën e të hollave, ndërmjet 75-140 euro*".
23. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu përmes të njëjtës padi pretendonte para Gjykatës Themelore se me kërkesë të tillë i është drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, por kjo e fundit nuk ka vendosur lidhur me kërkesën e tij. Parashtruesi i

kërkesës pretendonte heshtje administrative dhe kërkoi nga Gjykata Themelore që të vendos *“vetë me aktvendimin e saj, lidhur me kompensimet e dallimit të pensionit të pleqërisë”*.

24. Më 15 korrik 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 494/19] kthej për plotësim padinë e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, duke kërkuar nga ky i fundit *“që të precizojë saktë kërkesëpadinë dhe t'i dorëzojë gjykatës mjetet juridike të parashtruara pranë organeve administrative”*.
25. Gjykata Themelore përmes të njëjtit aktvendim arsyetoi: *“... se padia e paditësit është jo e plotë, jo e rregullt pasi që nuk precizohet saktë kërkesëpadia, akti të cilin kërkon ta anulon”*.
26. Më 4 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës plotësoi padinë përmes së cilës kërkoi *“dallimin në të holla për tetë (8) vite ndërmjet 75 dhe 140 euro”*, duke kërkuar fillimisht ekspertizë financiare në rastin e tij. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendonte se i është drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që të vendos ta realizoj kërkesën e tij, por e njëjta nuk ka vendosur.
27. Më 25 gusht 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 494/19], duke u bazuar në nenin 34 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktin Administrativ (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Konfliktin Administrativ), hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të palejueshëm, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur aktin përfundimtar administrativ që e konteston dhe nuk ka dëshmuar fillimisht shfrytëzimin e mjeteve juridike para organit administrativ kompetente lidhur me kërkesën e tij.
28. Më 15 shtator 2021, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
29. Më 3 dhjetor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA. nr. 886/2021] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin [A. nr. 494/19] e Gjykatës Themelore.
30. Më 26 janar 2022, kundër aktvendimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës dhe aplikim të gabuar të të drejtës materiale me propozimin që çështja t'i kthehet shkallës së parë për rishqyrtim.
31. Më 24 shkurt 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Arj. UZVP. nr. 15/2022] refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe vërtetoi Aktvendimin [AA. nr. 886/2021] e Gjykatës së Apelit të 25 gushtit 2021 me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet për fillimin e konfliktit administrativ, meqë parashtruesi nuk ka arritur të bëjë të qartë kërkesën e tij që do të aludonte në anulimin e ndonjë akti administrativ përfundimtar në procedurën administrative.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
33. Parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon shkelje/moszbatim të nenit 31 të Kushtetutës si rezultat i refuzimit të ankesës së tij nga gjykatat e rregullta lidhur me kërkesën e tij për pensionin e pleqërisë.
34. Parashtruesi i kërkesës përgjatë pretendimeve të tij thekson: *“sipas mendimeve të Gjykatës, shkallës së parë, instanca e dytë (Apeli) dhe Gjykata Supreme koncentrohet te heshtja administrative, nenin 29 LKA-së, për çdo Ligj për Procedurën Administrative nenin 130.2, e përmend heshtjen administrative, por nuk e cek afatin tjetër prej 7 ditëve”*.
35. Parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se e drejta e tij lidhur me pensionin i është cenuar sepse shuma do duhej të ishte 140 euro.
36. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson se *“Sigurimi pensional dhe invalidor, padyshim janë forma ma me rëndësi të sigurimit social të njerëzve, punonjësve të familjarëve të tyre, ku ata realizojnë prestime të caktuara, nga organet e caktuara kompetente për sigurimin social të tyre. E tërë kjo konsiston të drejta në sistemin social të sigurimit”*.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

LIGJI Nr. 03/L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Neni 13

Konflikti administrativ

1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.
2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.

Neni 14

Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj.

Neni 29

*1. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, **ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur**, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa.*

Neni 34

1. Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se:

[...]

1.5. është fjala për çështjen për të cilën sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ;

Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Neni 126

Përmbajtja dhe forma e ankesës

Ankesa duhet të përcaktojë aktin apo heshtjen administrative që ankimohet, shkaqet dhe arsyen pse ankimohet dhe organin publik kompetent për aktin.

2. Çdo kërkesë, edhe në qoftë se nuk shënohet shprehimisht si ankesë, do të konsiderohet e tillë, në qoftë se qëllimi i palës për të kundërshtuar një akt apo heshtjen administrative është mjaftueshëmërisht i qartë”.

Neni 127

Afati kohor për parashtrimin e ankesës

[...]

4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Neni 133

Ankesa kundër heshtjes administrative

1. Ankesa kundër heshtjes administrative shqyrtohet drejtpërdrejt nga organi epror. Organi epror i kërkon menjëherë organit kompetent, që pa vonesë të paraqesë të gjithë lëndën e rastit dhe një raport me shkrim mbi arsyet e heshtjes administrative.
2. Organi epror fillimisht do të shqyrtojë nëse ankesa është e pranueshme dhe, vetëm nëse ankesa është e pranueshme, do të shqyrtojë kërkesën e palës, siç i është parashtruar organit kompetent.
3. Organi epror do të vendosë mbi kërkesën në bazë të lëndës së rastit, apo nëse është e nevojshme do të zhvillojë shqyrtime administrative shtesë, apo do të urdhërojë organin kompetent që të zhvillojë shqyrtime administrative të tilla dhe ta njoftojë për rezultatet e shqyrtimit.
4. Përpos kur është e paraparë ndryshe me ligj, organi epror do të zgjidhë çështjen me një akt të vetin përfundimtar. Paragrafi 5 i nenit 131 të këtij ligji do zbatohet edhe në këtë rast.

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
39. Gjykata më tej i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

40. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ. UZVP. nr. 15/2022], të 24 shkurtit 2022, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.
41. Megjithatë, përveç këtyre kritereve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënregullit (2) të Rregullores së punës, që përcakton:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*
42. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemmachev kundër Francës, Kërkesa nr. 17621/91](#), kategoria (i), [Mentzen kundër Letonia, Kërkesa nr. 71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës, Kërkesa nr. 4241/03](#), kategoria (iii)).
43. Gjykata në këtë aspekt dhe fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës iu ishte drejtuar gjykatave të rregullta duke mos kontestuar ndonjë akt specifik administrativ, por duke pretenduar në esencë realizimin e kërkesës së tij për kompensim të dallimit lidhur me pensionin e pleqërisë dhe duke pretenduar heshtjen administrative nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
44. Çështja e parashtruesit të kërkesës ishte shqyrtuar përmes 3 (tre) vendimeve gjyqësore, duke u vendosur fillimisht nga Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 494/19] të 25 gushtit 2021, e cila duke u bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit për Konfliktin Administrativ refuzoi padinë e paraqitur sepse parashtruesi i kërkesës nuk kishte kontestuar ndonjë akt administrativ para saj dhe se nuk kishte dëshmuar se i njëjti iu ishte drejtuar fillimisht organit kompetent në kuptim të shterimit të mjeteve juridike lidhur me pretendimet e tij, duke përfshirë pretendimin për heshtje administrative. Ky aktvendim ishte konfirmuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, duke argumentuar se parashtruesi i kërkesës nuk arriti të provojë se kishte filluar procedurën fillimisht në organet kompetente administrative lidhur me pretendimet e tij, siç kërkohet nga Ligji për Konfliktin Administrativ dhe Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Po ashtu, ato vlerësuan se nuk ekziston ndonjë akt administrativ që të ketë dalë fillimisht në procedurë administrative dhe që të jetë i kontestueshëm më pas në procedurë gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke pretenduar se të njëjtat janë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, me arsyetimin se të gjitha rezultuan në refuzimin e ankesës së tij duke mos trajtuar heshtjen e pretenduar administrative të organit administrativ në ndërlidhje me kërkesën e tij për dallimin monetar të pensionit të pleqërisë.

45. Lidhur me këtë pretendim, dhe siç është reflektuar tek pjesa që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesit të kërkesës në paragrafët 31-35 të këtij aktvendimi, përtej pretendimit se vendimet e gjykatave të rregullta janë të nxjerra në “moszbatim të nenit 31 të Kushtetutës”, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur para Gjykatës asnjë argument dhe/ose arsye konkret përkitazi me shkeljet e të drejtave të tij e të cilat ai i pretendon.
46. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore sipas së cilës vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsye të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës [KI02/18](#), parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe [KI95/19](#), parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31).
47. Një qëndrim i tillë i Gjykatës është i bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Bazuar në këtë praktikë, dhe atë tashmë të konsoliduar të Gjykatës, pretendimet apo ankesat e paarsyetuara dhe të pambështetura me argumente e prova, shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese (shih, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 gushtit 2023 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave).
48. Gjykata rikujton se të njëjtat pretendime të përgjithshme përkitazi me kërkesën e tij për pensionin e pleqërisë dhe heshtjen e pretenduar administrative ishin paraqitur edhe para gjykatave të rregullta.
49. Në këtë kontekst, dhe specifikisht lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 494/19] të 25 gushtit 2021, duke trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke iu referuar dispozitave përkatëse të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe Ligjit të Konfliktit Administrativ kishte theksuar si në vijim:
- “Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, referuar ecurisë së çështjes, gjykata ka gjetur se paditësi me padi dhe plotësimin e **padisë nuk e ka bashkëngjitur asnjë akt përfundimtar administrativ apo mjetet të cilat i ka parashtruar para organit administrativ në kuptim të nenit 29 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Paditësi nuk ka paraqitur prova se ka ushtruar kërkesë të përsëritur në afatin ligjor prej 7 ditësh pas kalimit të afatit nga dita kur ka mundur të nxjerr vendim lidhur me ankesën e palës në kuptim të nenit 29 të Ligjit për Konfliktet Administrative, andaj në këtë kuptim konstatohet mos plotësimi i kushteve ligjore në kuptim të nenit 13, 14 dhe 29 të Ligjit për Konfliktet Administrative”.***
50. Gjithashtu, Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA. nr. 886/2021] të 4 tetorit 2019, në kontekst të këtij pretendimi specifik të parashtruesit të kërkesës, kishte theksuar si në vijim:

“Në rastin konkret, duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se padia e paditësit është e palejueshme, ngase në këtë çështje juridike nuk janë plotësuar kushtet për fillimin e konfliktit administrativ, meqë paditësi siç u theksua më lart nuk ka arritur të bëjë të qartë kërkesën e tij që do të aludonte në anulimin e ndonjë akti administrativ përfundimtar në procedurën administrative, si dhe nuk ka dëshmuar se i njëjti ka shtjerr mjetet juridike në kuptim të nenit 124, par.6 të LPPA-së dhe neni 29 të LKA-së”.

51. Në fund, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Arj. UZVP. nr. 15/2022] të 24 shkurtit 2022, në përgjigje të pretendimeve specifike të parashtruesit të kërkesës, kishte theksuar:

“Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj Gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë kanë vlerësuar se padia e paditësit është e palejueshme, ngase në këtë çështje juridike nuk janë plotësuar kushtet për fillimin e konfliktit administrativ, meqë paditësi nuk ka arritur të bëjë të qartë kërkesën e tij që do të aludonte në anulimin e ndonjë akti administrativ përfundimtar në procedurën administrative. Me nenin 17 të LKA-së përcaktohet se në procedurën e konfliktit administrativ, mund të kërkohet edhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet. Kjo nënkupton se procedura për fillimin e konfliktit administrativ për kompensim dëmi mund të iniciohet kur paditësi kërkesës kryesore të tij ia bashkon edhe kërkesën për kompensim që i ka bërë e paditura. Në rastin konkret, paditësi nuk ka dëshmuar se organi i paditur ka nxjerrë ndonjë akt përfundimtar për të cilin kërkohet anulimi i tij e në bazë të cilit do të merrej vendimi për kompensim të dëmit”.

52. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta në rrethanat e rastit konkret, kishin trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Të njëjtat kishin trajtuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, dhe kishin sqaruar se (i) parashtruesi i kërkesës nuk ka kontestuar para gjykatave një akt konkret administrativ të nxjerrë nga një procedurë administrative në kuptim të nenit 13 të Ligjit për Konfliktet Administrative; si dhe (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se ka shteruar mjetet juridike fillimisht para organit administrativ lidhur me pretendimet e tij në kuptim të paragrafit 6 të nenit 124 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 29 të Ligjit për Konfliktet Administrative.
53. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përgjatë gjithë procesit gjyqësor në esencë kishte kontestuar/pretenduar heshtjen administrative nga organet administrative me arsyetimin se nuk kishte marrë përgjigje nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me kërkesën e tij për pensionin e pleqërisë.
54. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në spikamë arsyetimin e Gjykatës Themelore, e cila në trajtim të këtij pretendimi specifik kishte arsyetuar në mënyrë të detajuar si në vijim:

[...]

“Me nenin 127, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcaktohet se:

Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”, kurse paragrafi 4 i po të njëjtit nen

përcakton se “Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”.

Me nenin 133, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Ankesa kundër heshtjes administrative shqyrtohet drejtpërdrejt nga organi epror. Organi epror i kërkon menjëherë organit kompetent, që pa vonesë të paraqesë të gjithë lëndën e rastit dhe një raport me shkrim mbi arsyet e heshtjes administrative.

[...] Paditësi nuk ka paraqitur prova se ka ushtruar kërkesë të përsëritur në afat ligjor prej shtatë ditësh pas kalimit të afatit nga dita kur ka mundur të nxjerr vendim lidhur me ankesën e palës në kuptim të nenit 29 të Ligjit për Konfliktet Administrative, andaj në këtë kuptim konstatohet mosplotësimi i kushteve ligjore në kuptim të nenit 13, 14 dhe 29 të Ligjit për Konfliktet Administrative”.

55. Përveç kësaj, Gjykata dëshiron të vë në dukje se Gjykata Themelore duke iu referuar kërkesës së parashtruesit për pensionin e pleqërisë dhe më pas edhe pretendimit për heshtje administrative të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, në mënyrë konkrete kishte theksuar:

“Duke pasur parasysh plotësimin e padisë, gjykata ka konstatuar se paditësi ka parashtruar kërkesën për realizimin e pensionit të pleqërisë në të cilën kërkesë nuk identifikohet datë adresimi, drejtuar këtu të paditurës lidhur me cenimin e të drejtës, duke theksuar se pensioni duhet të jetë 140 euro dhe pastaj me datë 25.02.2019 me padi i adresohet kësaj gjykate, andaj bazuar në ecurinë e çështjes paditësi nuk atakon asnjë akt administrativ përfundimtar, nuk ka proceduar para gjykatës shterjen e mjeteve juridike në kuptim të nenit 124, paragrafi 6 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 29 të Ligjit për Konfliktet Administrative, heshtje administrative në mënyrë që të kërkoj dallimin në të holla për tetë vite në shumën ndërmjet 75-140 euro”.

56. Gjithashtu, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA. nr. 886/2021] lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me kërkesën e tij për pensionin e pleqërisë, përgjatë vendimmarrjes së saj kishte vënë në dukje si në vijim:

“[...] Pra, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësi ka bashkëngjitur kërkesën për realizimin e pensionit të pleqërisë, kërkesë kjo e padatur, mirëpo i njëjti nuk ka dorëzuar kërkesën e përsëritur në kuptim të nenit 29 të LKA-së, Prandaj, gjykata ka ardhur në përfundim se paditësi në asnjë fazë të procedurës nuk ka ofruar dëshmi se i njëjti ka vepruar në bazë të dispozitave të LKA-së dhe LPPA-së, për zhvillimin e procedurës gjyqësore të konfliktit administrativ, ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore të lartcekura”.

57. Ndërsa, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit të saj [ARJ. (UZVP) nr. 15/2022], duke iu referuar gjendjes faktike në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës kishte konfirmuar gjetjet e Gjykatës së Apelit, duke vlerësuar si në vijim:

[...] pohimet në kërkesën e paditësit janë të pabazuara sepse ato nuk ndikojnë në nxjerrjen e vendimit të ndryshëm të gjendjes faktike nga ajo që ka gjetur gjykata e shkallës së dytë. Vendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë

dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Po ashtu, e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit”.

58. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte dështuar që të dëshmoj para gjykatave të rregullta nëse ka iniciuar procedurë para organit administrativ lidhur me pretendimet e tij për heshtje administrative, specifikisht nëse ka kontestuar heshtjen administrative të pretenduar nga ai fillimisht brenda organit administrativ, respektivisht në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
59. Gjykata rikujton se ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar dosjen origjinale të rastit, duke kërkuar atë nga Gjykata Themelore në mënyrë që të këtë një gamë të plotë të informacioneve lidhur me çështjen në fjalë.
60. Prandaj, Gjykata duke iu referuar dosjes origjinale dhe fakteve të rastit vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se ka ushtruar kërkesë të përsëritur në afatin ligjor prej 7 ditësh pas kalimit të afatit nga dita kur ka mundur të nxjerr vendimin lidhur me ankesën e palës në kuptim të nenit 29 të Ligjit për Konfliktet Administrative.
61. Gjykata vëren interesin e parashtruesit për realizimin e kërkesës së tij në procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta, por mungesa e maturisë apo kujdesit të nevojshëm lidhur me respektimin e hapave proceduralë mund të kontribuojë në mënyrë vendimtare lidhur me rezultatin përfundimtar të rastit të parashtruesit.
62. Siç u sqarua më lart, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk sjell asnjë argument apo arsytim shtesë në mbështetje të pretendimeve të tij për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese. Për pasojë, Gjykata bazuar në Rregulloren e saj të punës, përkatësisht paragrafi 2 të rregullit 34 të saj, duhet të shpallë këtë kërkesë të papranueshme si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, sepse parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij (shih rastin e Gjykatës KI179/19, parashtrues *Ardian Ymeri*, aktvendimin për papranueshmëri, i 15 prillit 2020, paragrafi 39).
63. Për sa më sipër, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, [*García Ruiz kundër Spanjës*](#), nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [*KI22/19*](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
64. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në rastin e parashtruesit të kërkesës kishte analizuar gjerësisht provat e paraqitura dhe pretendimet e ngritura nga palët në procedurë. Për më tepër, Gjykata gjen se vendimmarrja e gjykatave të rregullta, në rrethanat faktike dhe juridike të rastit konkret ishte e bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe Ligjit për Konfliktet Administrative që ato i kishte konsideruar si të aplikueshme dhe relevante përkitazi

me rrethanat e rastit konkret dhe me pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në procedurë.

65. Gjykata, në fund, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, nr. 5503/02](#), Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
66. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
67. Prandaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të deklarohet qartazi e pabazuar, sepse këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii), pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, më 30 prill 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani